



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Nr. 1739/11 Prot.

Tiranë, më 14/12 /2017

Lënda: Miratim transferim kuotash

Znj. Harallambe Gjoka

Shoqëria Konçesionare "C&S Energy" sh.p.k. ✓

Shoqëria "Eko Vepra" sh.p.k.

Rruga e Kavajes nr. 151, Njesia Bashkiake nr. 7,

Tiranë

Z. Ferid Sukaj

Z. Arjan Cukaj

Shoqëria "C&S Construction" sh.p.k.

Lagja 1

Sarandë

Në përgjigje të shkresës se shoqërisë "Eko Vepra" sh.p.k. me nr. 049 Prot. date 9.11.2017 (Protokolluar pranë MIE me nr. 1739 date 7.11.2017), me ane te se cilës kërkohet miratimi i transferimit të 2% te kuotave qe zotëron shoqëria "C&S Construction" sh.p.k. tek shoqëria koncesionare "C&S Energy" sh.p.k., në favor të shoqërisë "Eko Vepra" sh.p.k., referuar Kontratës së Konçesionit e formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentraleve "Rapun 3", "Rapun 3A" dhe "Rapun 4" me nr. 2854 Rep., nr. 383 Kol. date 11.9.2009, e ndryshuar, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, ju njoftojmë se:

Miratojmë transferimin e kuotave me kushtin që të ruhet emri i Koncesionarit si dhe të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e koncesionit midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, në të kundërt marrëveshja është e pavlefshme.

Pas kryerjes së të gjitha procedurave për realizimin e këtij transferimi të kuotave, të depozitohet pranë Autoritetit Kontraktues, ekstrakti i regjistrit tregtar nga QKR për shoqërinë konçesionare "C&S Energy" sh.p.k. ku të jetë e reflektuar kryerja e këtij transferimi.

Me kryerjen e transferimit dhe pasqyrimin e ketij ndryshimi ne QKR, perfaqesuesi i shoqerise koncesionare, duhet te paraqitet prane Ministrise se Infrastrukturës dhe Energjisë, per te amenduar ndryshimet perkatese ne Marreveshjen e Koncesionit ne fjale.

Ju rikujtojmë gjithashtu, që në bazë të Kontratës së Koncesionit, ju duhet të raportoni në vazhdimësi për ecurinë e zbatimit të kësaj kontrate.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

MINISTRI
Damian Gjijknuri

